

PROJEKTLIGJ PËR NDRYSHIMIN E KODIT ZGJEDHOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

(Miratuar me Ligjin Nr.10019, Datë 29.12.2008, dhe ndryshuar me Ligjin Nr.74/2012, Datë 19.07.2012 dhe Ligjin Nr. 31/2015, Datë 02.04.2015)

Neni 1 **Qëllimi i ligjit**

- Pas pikës 1 të Nenit 1 të shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“Ky kod ka për qëllim përcaktimin e rregullave për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë dhe referendumet për zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

- Në gërmën “ç” të shtohet togfjalëshi “për votimin brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë” si dhe në gërmën “e” të pikës 2, të nenit 1, të shtohen togfjalëshat “numërimit” dhe “për votimin brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

Në këtë Kod janë objekt i rregullimit:

- a) caktimi i zonave zgjedhore;
- b) afatet, procedura dhe kompetenca për regjistrimin e subjekteve zgjedhore;
- c) organizimi dhe funksionimi i administratës dhe komisioneve zgjedhore;
- ç) afatet, procedura dhe kompetencat për përgatitjen e listës së zgjedhjeve **për votimin brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.**;
- d) financimi i subjekteve zgjedhore;
- dh) zhvillimi i fushatës zgjedhore;
- e) procedura e votimit, **numërimit** dhe shpalljes së rezultateve **për votimin brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”;**
- ë) përgjegjësitë, organizimi dhe funksionet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe organeve të tjera zgjedhore;
- f) shqyrtimi i ankimeve dhe vendosja e sanksioneve administrative dhe penale;
- g) rregulla të tjera në lidhje me zgjedhjet.

Neni 2 **Përkufizimet**

- Pika 7 e Nenit 2 të riformulohet si më poshtë vijon:

“KQZ” është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili është organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Kod.”

- Pika 9 të riformulohet si më poshtë vijon:

“Listat e zgjedhësve ndahen në dy kategori:

- i. Listat e zgjedhësve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilat burojnë nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes civile për çdo zonë të qendrës së votimit, të hartuara në përputhje me këtë Kod.
- ii. Listat e zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë që burojnë nga shprehja e vullnetit të zgjedhësit në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara në këtë Kod.

- Pika 18 të riformulohet si më poshtë vijon:

“Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve” është rezultati i shpallur nga KQZ-ja, në përputhje me këtë Kod dhe që përfshin:

- a) numrin e votave, numrin e mandateve dhe listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt në zonën zgjedhore, si dhe në shkallë vendi **bazuar në votimet brenda dhe jashtë Shqipërisë**, në përputhje me rregullat e këtij Kodi;
- b) rezultatin e votimit për kandidatët për kryetarë bashkie, të cilët janë zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë në zonë zgjedhore përkatëse;
- c) numrin e votave të fituar nga secili subjekt në shkallë kombëtare, bazuar në rezultatin e votave të fituara nga çdo subjekt zgjedhor në votimin për këshillat e qeverisjes vendore; dhe
- ç) rezultatin e votimit për çdo alternativë në referendum **për votimet brenda dhe jashtë Shqipërisë**, sipas dispozitave të këtij Kodi.

- Të shtohen përkufizimet në nenin 2:

Pika x

“Zgjedhës brenda territorit të Republikës së Shqipërisë” janë votuesit me vendbanim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

Pika x

“Zgjedhës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë” janë shtetasit shqiptarë, që kanë shprehur paraprakisht vullnetin për të ushtruar të drejtën e votës jashtë vendit dhe janë pjesë e listës së zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Këta persona regjistrohen sipas vendbanimit të tyre të fundit në Republikën e Shqipërisë.

Pika x

“Shprehja e vullnetit” është procesi me anë të së cilit zgjedhësi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë konfirmon sipas procedurës përkatëse se do të ushtrojë të drejtën e tij për të votuar jashtë vendit.”

Pika x

“Votimi me postë fizike” nënkupton dorëzimin e dërgesës postare (zarfin me fletëvotimin) në postën e vendit ku jeton zgjedhësi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe dërgesa postare vulozet nga posta përkatëse me rastin e dorëzimit.

Pika x

“Zarf zgjedhor”, është materiali zgjedhor që i dërgohet shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përgjigje të shprehjes së tij të vullnetit për të zgjedhur, i cili përmban fletët e votimit dhe udhëzimet për mënyrën e votimit në zgjedhjet përkatëse.”

Pika x

“Zarfi i dërgimit” është materiali i cili gjendet brenda zarfit zgjedhor dhe përdoret për postimin e fletëve të plotësuara të votimit.

Pika x

“Kuti Postare në Shqipëri” – Kuti postare e hapur nga KQZ-ja në Postën e Shqipërisë, që shërben për të dërguar fletëvotimet shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë që regjistrohen sukseseshëm për votim jashtë Shqipërisë.

Pika x

“Kuti Postare jashtë Shqipërisë” – Kuti postare e hapur nga KQZ-ja, me ndihmën e përfaqësive diplomatike në postat e shteteve ku ka shtetas të Republikës së Shqipërisë në numër të konsiderueshëm, që shërbejnë për të dërguar fletëvotimet shtetasit që regjistrohen sukseseshëm për votim jashtë Shqipërisë.

Pika x

“Qendra e Numërimit dhe Rezultateve” është mjedisi i caktuar ku numërohen fletëvotimet për votimet jashtë Shqipërisë, dhe ku çdo fletëvotim i rregullt për çdo subjekt në zonën zgjedhore, auditohet duke përpiluar kështu rezultatin përfundimtar.

Pika x

Periudha e konfirmimit të vullnetit është periudha kohore që lihet në dispozicion nga KQZ brenda së cilës shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës mund të depozitojnë kërkesën e tyre për të votuar për zgjedhjet në Kuvend apo referendum.

Pika x

“Përfaqësi Diplomatike” është cdo ambasadë, konsullatë, mision diplomatik dhe mision konsullor, që përfaqëson Republikën e Shqipërisë në një shtet tjetër dhe në periudhën e votimit mund të shfrytëzohet si qendër e mbledhjes së zarfeve zgjedhore të votimit, sipas vlerësimeve të KQZ-së, për t’i nisur më tej për në territorin e Shqipërisë.

Pika x

“Struktura administrative përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë” ngrihet brenda Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe funksionon në përputhje me këtë Kod. Kjo strukturë është përgjegjëse për administrimin e votës së shtetasve me vendbanim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë dhe referendumet.

Pika x

“Certifikata e zgjedhësit” është dokumenti me anë të cilit zgjedhësi deklaron se ka ushtruar i lirë dhe nën përgjegjësinë e tij të drejtën e votës. Kjo certifikatë nënshkruhet dhe datohet nga vetë zgjedhësi.

- Pas nenit 11 shtohet neni 11/1 me këtë përmbajtje:

Neni 11/1

Koha e votimit për zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

Për zgjedhësit që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, koha e votimit përcaktohet me vendim të KQZ, por gjithmonë realizohet përpara votimeve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

- Të shtohet **KREU X "Votimi i zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë"** në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë me përmbajtjen e mëposhtme:

Neni 1

Qëllimi

Kjo pjesë e Kodit ka për qëllim të përcaktojë: mënyrën e regjistrimit të zgjedhësit që shpreh vullnetin për të votuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë dhe referendumet; mënyrën e votimit; trajtimin e materialit zgjedhor; si dhe numërimin e fletëvotimit të zgjedhësve që kanë votuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

Neni 2

Parimet e përgjithshme

1. Zgjedhësi me të drejtë vote i cili përkohësisht banon jashtë, ose është zhvendosur nga Shqipëria në mënyrë të përhershme ka të drejtë të votojë në zgjedhje sipas procedurave dhe afateve kohore të përcaktuara në këtë ligj.
2. Zgjedhjet për zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë janë periodike dhe në përputhje me zhvillimin e zgjedhjeve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Votimi që ushtrohet nga zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kryhet në bazë të parimit të lirisë, fshehtësisë, barazisë, shprehjes së drejtpërdrejtë dhe të lirë të vullnetit sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod.

4. Zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kanë të drejtën e vetëm një vote për çdo lloj procesi zgjedhor për Kuvendin e Shqipërisë apo referendum, në të kundërt përgjigjen penalisht.
5. Zgjedhësit mund të ushtrojnë të drejtën e votës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nëse paraprakisht kanë shprehur vullnetin dhe kanë vendbanimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. E drejta e votës realizohet vetëm në bazë të shprehjes së lirë të vullnetit të zgjedhësit të interesuar.
6. Ushtrimi i të drejtës së votës për zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është falas dhe garantohet me ligj. Ai mundësohet nga operatori postar sipas parashikimeve të udhëzimeve të KQZ-së.

Neni 3

Kriteret për përfshirjen e zgjedhësit në listën e jashtme të zgjedhësve

Kriteret për përfshirjen e një personi në listën e jashtme të zgjedhësve janë:

- (a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- (b) të ketë mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe në datën e zgjedhjeve;
- (c) të mos jetë shpallur me vendim gjyqësor të formës së prerë si i pazoti për të vepruar;
- (d) të ketë vendbanim/vendqëndrim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Regjistrimi i zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

1. Zgjedhësi i cili ka vendbanimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës duhet të regjistrohet në listat e zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në bazë të shprehjes së vullnetit me kërkesën e veçantë për të marrë pjesë në procesin zgjedhor të radhës.
2. Shprehja e vullnetit për të votuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë bëhet:
 - a) duke aplikuar online nëpërmjet formularit në Platformën Elektronike në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së;
 - b) përmes postës, në një nga Kutitë Postare të KQZ-së.
3. Modeli i kërkesës për të ushtruar të drejtën e votës nga zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përcaktohet me udhëzim të KQZ-së. Elementët kryesorë që duhet të përmbajë kërkesa për votimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë janë:
 - a) llojin e procesit zgjedhor;
 - b) emrin dhe mbiemrin e zgjedhësit;
 - c) numrin personal;
 - d) adresën e plotë të vendbanimit ose vendqëndrimit (sipas rastit);
 - e) kodin postar të vendbanimit ose vendqëndrimit;
 - f) serinë dhe numrin e dokumentit biometrik;
 - g) data e plotësimit të kërkesës.

4. Kërkesa shoqërohet me kopjen e dokumentit biometrik si dhe me vërtetimin e vendbanimit jashtë vendit, ose respektivisht një kartë identiteti dhe një kopje e dokumentit që vërteton të drejtën e qëndrimit lëshuar nga autoritetet e huaja.
5. Dokumenti i identifikimit dhe leja e qëndrimit që shoqërojnë kërkesën duhet të jenë të vlefshme.
6. Aplikimi i shprehjes së vullnetit për të votuar duhet të bëhet nga dita e shpalljes së datës së zgjedhjeve dhe deri në datën e përcaktuar në udhëzimet përkatëse të KQZ-së.
7. Lajmërimi për shpalljen e datës së zgjedhjeve përmban të dhëna për llojin e zgjedhjeve për të cilat votohet, thirrje për shikim publik në listën zgjedhore dhe për paraqitje të votimit, ditën e fillimit dhe përfundimit të paraqitjes për votim, dokumentet e nevojshme, si dhe sqarime kush mund të votojë dhe ku do të zbatohet votimi.
8. KQZ, për qëllime të aplikimit dhe regjistrimit të shtetasve jashtë Republikës së Shqipërisë sipas pikës 4 të këtij neni, zbaton afat të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm, por jo më të shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë.
9. KQZ, për qëllime të aplikimit dhe regjistrimit të shtetasve të Republikës së Shqipërisë sipas pikës 4 të këtij neni, merr masa të nevojshme për informimin dhe edukimin e votuesve, duke përfshirë dhe pa u kufizuar në mënyrën e aplikimit dhe regjistrimit, platformat elektronike të zbatueshme dhe promovimin e standardeve më të larta demokratike për sigurimin e materialeve të votimit, fshehtësinë e votës, personalizimin dhe paprekshmërinë e saj.

Neni 5

Administrimi i kërkesave për të ushtruar të drejtën e votës

1. Kërkesa e cila përmban datën dhe të dhënat e zgjedhësit që shpreh vullnetin për të votuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dërgohet pranë Strukturës administrative përgjegjëse për administrimin e votës jashtë vendit pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.
2. Regjistrimi konsiderohet i kryer kur të dhënat e kërkuara në platformën elektronike janë të plota dhe të sakta dhe në përputhje me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Verifikimi i këtyre të dhënave kryhet nga Struktura administrative përgjegjëse për administrimin e votës jashtë vendit në KQZ brenda 5 ditësh nga data e shprehjes së vullnetit të zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. KQZ-ja publikon listën e votuesve jashtë Republikës së Shqipërisë në faqen e saj zyrtare të internetit të paktën një muaj para datës së zgjedhjeve.
4. Lista përmban vetëm të dhëna dhe informacione të përfuara nga votuesit me anë të formularëve online të shprehjes së vullnetit, për të cilat zgjedhësit kanë pranuar publikimin e tyre në bazë dhe për zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave në Republikën e Shqipërisë. Në listë, emrat e zgjedhësve që kanë shprehur interesin të votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, janë të renditur sipas alfabetit, dhe sipas shteteve të deklaruara në adresën e vendbanimit ose vendqëndrimit të zgjedhësit jashtë Republikës së Shqipërisë.
5. KQZ brenda afatit të sipërpërmendur, vendos listat elektorale të zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në dispozicion edhe nëpërmjet operatorit postar të përzgjedhur prej saj.

Neni 6

Lista e zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

1. Lista e zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është një listë e vetme për gjithë vendin dhe përmban të gjithë zgjedhësit që kanë shprehur paraprakisht vullnetin për të ushtruar të drejtën e votës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

Lista e zgjedhësve jashtë Republikës së Shqipërisë përmban këto elementë:

- a) llojin e procesit zgjedhor;
 - b) emrin dhe mbiemrin e zgjedhësit;
 - c) numrin personal;
 - d) vendbanimin ose vendqëndrimin (sipas rastit);
 - e) serinë dhe numrin e dokumentit biometrik;
 - f) kodin postar të vendbanimit ose vendqëndrimit;
 - g) rubrikën për datën e regjistrimit të zarfit të jashtëm dhe datën e hedhjes/futjes së zarfit të brendshëm në kutinë e votimit nga struktura administrative përgjegjëse për administrimin e votës jashtë vendit.
2. Kriteret specifike për përfshirjen e zgjedhësve në këtë listë janë shprehja e vullnetit paraprak për ushtrimin e të drejtë për të zgjedhur, dhe deklarimi i një adrese të vlefshme për marrjen e zarfit dhe materialeve zgjedhore.
 3. Lista e zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë gjenerohet nga Struktura administrative përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si pjesë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe funksionon në përputhje me këtë Kod.
 4. Shtetasit që kanë paraqitur kërkesën për të votuar ndahen sipas qarqeve elektorale në të cilat ju figuron emri në Shqipëri, sipas vendbanimit të tyre të fundit që kanë pasur në Shqipëri.
 5. Emrat e shtetasve që kanë paraqitur kërkesën për të votuar jashtë largohen nga listat e votuesve që votojnë brenda territorit të Shqipërisë për të shmangur mbivendosjet.
 6. Në të njëjtën kohë shtetasve jashtë vendit do t'u kërkohej të nënshkruajnë dhe një deklaratë ku të shprehin pëlqimin që emrat e tyre të hiqen nga listat e votuesve brenda vendit duke i vendosur në një listë të posaçme për votuesit jashtë vendit.
 7. Shtetasve me banim jashtë shtetit ju dërgohet një kod individual regjistrimi në formën e një bar-kodi të skanueshëm i cili do të shërbejë si element kryesor identifikues, ku përveç të dhënave personale të “votuesit të jashtëm” do të përfshihet dhe informacioni për qarkun ku vota e tij do të llogaritet.
 8. Informacioni që përmban bar-kodi do të jetë i shifruar dhe do t'i referohet informacionit të bazës së të dhënave qendrore për votuesit jashtë vendit të krijuar nga struktura e caktuar për të administruar votën e shtetasve shqiptarë jashtë atdheut.
 9. Dërgimi i kodit individual të regjistrimit do të kryhet me anë të postës elektronike ose postës rekomande dhe duhet të përfundojë x ditë përpara zhvillimit të zgjedhjeve. Shtetasit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të cilët ende nuk kanë marrë kodin individual të regjistrimit kanë mundësi ankimimi.

10. Ky process duhet të fillojë të paktën x ditë përpara ditës së zgjedhjeve dhe duhet të përfundojë të paktën x ditë përpara ditës së zgjedhjeve.
11. Lista e votuesve do të jetë publike edhe në vitet jo zgjedhore, ku zgjedhësit do të kenë mundësi që të njoftohen lidhur me qendrat e votimit dhe të kërkojnë ndërrimin e qendrave të votimit. Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile është e detyruar që së paku dy herë në vit t'i ofrojë KQZ-së ekstraktin e Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

Neni 7

Shqyrtimi i Listës së Zgjedhësve dhe Procedura e Kundërshtimit

1. Zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me të drejtë vote mund të kundërshtojnë pasaktësitë apo gabimet në Listën e Zgjedhësve gjatë periudhës së vendosur për këtë qëllim nga KQZ-ja.
2. Çdo person që ka aplikuar për t'u regjistruar si zgjedhës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, që nuk figuron në Listën e Zgjedhësve, mund të parashtojë ankesë në KQZ përmes postës ose sistemit elektronik, për mospërfshirjen e tij, duke përfshirë një nga dokumentat e mëposhtme të identifikimit:
 - a) Letërnjoftim të vlefshëm;
 - b) Pasaportë të vlefshme.
3. Ankesa e personit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë që dorëzohet në KQZ në mënyrë elektronike, duhet të jetë e nënshkruar, e skanuar dhe duhet të ketë të bashkangjitura dokumentet e vlefshme të identifikimit të lëshuara nga organet kompetente të Republikës së Shqipërisë, të cilat identifikojnë ankuesin. Ankesa e tillë, dërgohet vetëm nga email - adresa personale e ankuesit.
4. KQZ ka detyrim të shqyrtojë ankesën brenda 48 orëve dhe të marrë një vendim duke shtuar ose jo emrin e personit në listën e zgjedhësve.

Neni 8

Mënyra e votimit

1. Në çdo rast, procesi i votimit të jashtë vendit do të zhvillohet përpara votimit në Shqipëri.
2. Zgjedhësi, pasi ka shprehur vullnetin për të votuar, merr konfirmimin zyrtar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Pas marrjes së konfirmimit zyrtar shtetasi shqiptar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ushtron të drejtën e votës sipas procedurës së mëposhtme:
 - a) merr zarfin zgjedhor brenda afateve të përcaktuara në këtë kod dhe udhëzimet e KQZ;
 - b) plotëson fletët e votimit dhe i vendos ato brenda zarfit të dërgimit;
 - c) në zarfin e dërgimit zgjedhësi gjithashtu vendos një fotokopje të dokumentit të identifikimit si dhe plotëson certifikatën e zgjedhësit;
 - d) fletët e votimit brenda zarfit zgjedhor të mbyllur hermetikisht, së bashku me kopjen e dokumentit të identitetit dhe certifikatës së zgjedhësit vendosen në zarfin e dërgimit dhe i dërgohen drejtpërdrejtë KQZ nga çdo pikë postare ose në përfaqësitë diplomatike të cilat më pas i nisin drejtpërdrejtë për në KQZ.

3. Zgjedhësi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është i detyruar t'i komunikojë menjëherë KQZ-së rreth vjedhjes, dëmtimit ose shkatërrimit të dokumenteve të sipërcituara për motive që nuk varen prej tij, si dhe në rastet kur zgjedhësi nuk ka marrë zarfin zgjedhor brenda afatit të përcaktuar në udhëzimet e KQZ-së.
4. KQZ mbulon shpenzimet e organizimit të votimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 9

Administrimi i zarfeve zgjedhorë

1. Zgjedhësit që votojnë mund t'i dërgojnë nëpërmjet postës zarfet e tyre zgjedhorë mund direkt në kutinë postare të KQZ-së në Shqipërisë, apo në adresë të kutisë postare jashtë Shqipërisë të hapura nga KQZ-ja, me ndihmën e përfaqësisë diplomatike, në shtetin ku voton votuesi, apo në shtetin më të afërt ku është e hapur kutia postare.
2. Në rastin e dytë, KQZ vendos rregullat e procedurës, shpërndarjes, pranimit, paketimit, transportin dhe sigurinë e materialeve për zgjedhje, të cilat dërgohen në përfaqësi diplomatike dhe më pas do të nisen drejtpërdrejtë për në KQZ. KQZ-ja me akt nënligjor përcakton ekipet, procedurat e pranimit, transportimit, paketimit dhe vleshmërinë e zarfeve, duke përfshirë edhe ekipet që do të shkojnë të marrin dërgesat në kutitë postare jashtë Shqipërisë. Materialet zgjedhore apo që ndërlidhen me votimin jashtë vendit, kanë statusin e dërgesës diplomatike.
3. Zarfi zgjedhor për votimin jashtë Shqipërisë, i dërguar me kutinë postare të KQZ-së në Shqipëri ose i dërguar përmes postës në kutinë postare jashtë Shqipërisë, pranohet nga KQZ-ja deri në 3 ditë pas ditës së zgjedhjeve, me kusht që të ketë vulën e dërgimit para ditës së zgjedhjeve.
4. Pas mbërritjes në Shqipëri të zarfeve, struktura përgjegjëse për administrimin e votës bën verifikimin e të dhënave të çdo shtetasi, pra skanon bar-kodin apo fut të dhënat në kompjuter, për të përcaktuar qarkun për të cilin është votuar. Vetëm pas kësaj, zarfet e pashënuar që përmbajnë votat e votuesve të jashtëm, shpërndahen sipas qarqeve elektorale përkatës, duke siguruar në këtë mënyrë fshehtësinë e votës së secilit votues.
5. Zarfët zgjedhorë nga votimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nuk hapen, nuk numërohen, apo vlerësohen. Këto materiale grumbullohen në prani të vëzhguesve të pranishëm, mbyllen në kuti të sigurta, shënjojnë në mënyrën e caktuar nga KQZ dhe dërgohen në zonat zgjedhore në Shqipëri.
6. Për dorëzimin e materialit zgjedhor përpilohet procesverbali, në të cilin posaçërisht duhet të shënohet numri i përgjithshëm i fletëvotimeve me numrat serialë dhe numri i duhur i listave të kandidatëve që vendosen në hapësirat e votimit .
7. Votat e mbledhura do të vinë dhe do të numërohen në strukturën e ngritur për këtë qëllim në qarqet zgjedhore dhe do të numërohen menjëherë apo pas atyre të zhvillimit të votimit në Shqipëri.
8. Procesi i votimit të jashtëm nisur nga regjistrimi i votuesve e deri tek numërimi i votave do të administrohet nga një strukturë e veçantë brenda KQZ e quajtur Komisioni Qëndror për Votën e Jashtme (KQVJ).

Neni 10

Numërimi i votave të zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

1. Procedura e numërimit të fletëvotimeve udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërimin dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës.
2. KQZ është përgjegjëse për administrimin e votave të zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Struktura administrative përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve jashtë Republikës së Shqipërisë sigurohet që fletëvotimet nga votimi i realizuar jashtë vendit të ruhen në një kuti të posaçme për votim e cila pas përfundimit të votimit ruhet e vulosur në hapësirat e KQZ-së dhe hapet pas përfundimit të votimit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11

Llojet e votave dhe kriteret për vlerësimin e votës së zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

1. Struktura administrative përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vlerëson vlefshmërinë e fletëve të votimit të zgjedhësit jashtë Republikës së Shqipërisë.
2. Vota në procesin zgjedhor shpallet e pavlefshme nëse:
 - a) vota është dërguar nga zgjedhësi i cili nuk ka zotësi për të vepruar;
 - b) mungon dokumenti i identifikimit dhe/ose certifikata e zgjedhësit;
 - c) zarfi i dërgimit nuk është mbyllur ose është dëmtuar aq sa mund të cenojë integritetin e votës nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - d) në të njëjtin zarf zgjedhor janë vendosur dy ose me shumë fletë votimi;
 - e) zarfi zgjedhor mbërrin në strukturën administrative përgjegjëse për votimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pas mbylljes së kohës së votimit të parashikuar në këtë Kod.
3. Vlerësimi i votave synon të identifikojë, sa të jetë e mundur, qëllimin e zgjedhësit. Në zbatim të këtij neni, KQZ-ja përgatit udhëzues të veçantë për të lehtësuar punën dhe unifikuar praktikën e vlerësimit të fletëve nga ana e komisioneve dhe personave të ngarkuar nga ky Kod për numërimin dhe vlerësimin e votave të zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.